



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

Tribunali Penal
Ndërkombëtar për
ish-Jugosllavinë

AKTAKUZË E NDRYSHUAR PËR TË TRETËN HERË

**MILLUTINOVIQ,
SHAINOVIQ, OJDANIQ**

IT-99-37-PT

Dorëzuar nga Prokurorja: 5 Shator 2002

Outreach Programme / Programi i Përhapjes

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31 70 512 5493/8274 Fax: +31 70 512 8953

Internet address: <http://www.un.org/ictv/index-a.html>

TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR
PËR ISH-JUGOSLLAVINË

Lënda Nr. IT-99-37-PT

PROKURORJA E TRIBUNALIT

KUNDËR

**MILLAN MILLUTINOVIQIT
NIKOLLA SHAINOVIQIT
DRAGOLUB OJDANIQIT**

AKTAKUZË E NDRYSHUAR PËR TË TRETËN HERË

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në përputhje me kompetencat e saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Statuti i Tribunalit”), akuzon:

**SLLOBODAN MILLOSHEVIQIN
MILLAN MILLUTINOVIQIN
NIKOLLA SHAINOVIQIN
DRAGOLUB OJDANIQIN
VLLAJKO STOJILKOVIQIN**

Për **KRIME KUNDËR NJERËZIMIT** dhe **SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS** siç parashtrohet më poshtë:

1. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u lind më 20 gusht 1941 në qytetin e Pozharevcit, në Republikën e sotme të Serbisë (më tej “Serbia”). Në vitin 1964 u diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit dhe filloi karrierë si drejtor dhe bankier. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mbajti postin e zëvendësdrejtorit dhe pastaj të drejtorit të përgjithshëm në kompaninë e madhe të gazit *Tehnogas* deri në vitin 1978. Pastaj u bë president i bankës *Beogradska Banka (Beobanka)*, njëra prej bankave më të mëdha në ish-Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej “RSFJ”), dhe mbeti në këtë pozitë deri më 1983.

2. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** filloi karrierën e tij politike në vitin 1983. U bë kryetar i Komitetit të Qytetit të Lidhjes së Komunistëve të Beogradit më 1984. Më 1986 u zgjodh kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe u rizgjodh më 1988. Më 16 korrik 1990, Lidhja e Komunistëve të Serbisë dhe Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë u bashkuan; partia e re u quajt Partia Socialiste e Serbisë (më tej “SPS”); **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u

zgjodh kryetar i saj. Ai vazhdon të mbajë postin e kryetarit të SPS-së deri më datën e kësaj aktakuze.

3. **Sillobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i Kryesisë së Serbisë më 8 maj 1989 dhe u rizgjodh më 5 dhjetor po atë vit. Pas hyrjes në fuqi të kushtetutës së re të Serbisë më 28 shtator 1990, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh në postin e sapokrijuar të kryetarit të Serbisë në zgjedhje shumëpartiake mbajtur më 9 dhe 26 dhjetor 1990; ai u rizgjodh më 20 dhjetor 1992.

4. Pas dy mandateve si kryetar i Serbisë, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i Republikës Federale të Jugosllavisë (më tej "RFJ") më 15 korrik 1997 dhe filloi nga detyrat zyrtare më 23 korrik 1997. Pas humbjes së tij në zgjedhjet presidenciale të shtatorit në vitin 2000, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** dha dorëheqjen nga kjo pozitë më 6 tetor 2000. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** ka qenë në postin e kryetarit të RFJ-së.

5. **Millan MILLUTINOVIQI** u lind më 19 dhjetor 1942 në Beograd, në Serbinë e sotme. **Millan MILLUTINOVIQI** u diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit.

6. Gjatë tërë karrierës së tij politike, **Millan MILLUTINOVIQI** ka mbajtur shumë poste të larta qeveritare në Serbi dhe në RFJ. **Millan MILLUTINOVIQI** ishte deputet në Dhomën Shoqërore-Politike dhe anëtar i Komitetit të Politikës së Jashtme në Kuvendin Federal. Ai ka qenë sekretar për Arsime dhe Shkencë në Serbisë; anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë; dhe drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Serbisë. **Millan MILLUTINOVIQI** ka shërbyer gjithashtu si ambasador në Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe si ambasador i RFJ-së në Greqi. Ai u emërua ministër i Punëve të Jashtme të RFJ-së më 15 gusht 1995. **Millan MILLUTINOVIQI** është anëtar i SPS-së.

7. Më 21 dhjetor 1997, **Millan MILLUTINOVIQI** u zgjodh kryetar i Serbisë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Millan MILLUTINOVIQI** ishte në postin e kryetarit të Serbisë.

8. **Nikolla SHAINOVIQI** u lind më 7 dhjetor 1948 në Bor, Serbi. Ai u diplomua në Universitetin e Lubjanës më 1977 dhe ka magjistruar në inxhinierinë kimike. Ai filloi karrierën e tij politike në komunën e Borit, ku mbajti postin e kryetarit të Kuvendit Komunal të Borit prej vitit 1978 deri më 1982.

9. Gjatë tërë karrierës së tij politike, **Nikolla SHAINOVIQI** ka qenë anëtar aktiv i Lidhjes së Komunistëve dhe i SPS-së. Ai ka mbajtur postin e kryetarit të Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve në Bor. Më 25 nëntor 1995, **Nikolla SHAINOVIQI** u zgjodh anëtar i Këshillit Drejtues të SPS-së dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të saj. Gjithashtu ai u caktua kryetar i komitetit për përgatitjen e Kongresit të Tretë të Rregullt të SPS-së (mbajtur në Beograd më 2-3 mars 1996). Më 2 mars 1996, **Nikolla SHAINOVIQI** u zgjodh si njëri prej disa zëvendëskryetarëve të SPS-së. Mbeti në këtë post deri më 24 prill 1997.

10. **Nikolla SHAINOVIQI** ka mbajtur disa poste në qeveritë e Serbisë dhe të RFJ-së. Më 1989 ai ishte anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë dhe sekretar për Industri, Energjetikë dhe Teknologji. U emërua ministër për Miniera dhe Energjetikë në Serbisë më 11 shkurt 1991 dhe përsëri më 23 dhjetor 1991. Më 23

dhjetor 1991 u emërua gjithashtu zëvendëskryeministër i Serbisë. **NIKOLLA SHAINOVIQI** u emërua ministër i Ekonomisë i RFJ-së më 14 korrik 1992 dhe përsëri më 11 shtator 1992. Ai dha dorëheqje prej këtij posti më 29 nëntor 1992. Më 10 shkurt 1993, **Nikolla SHAINOVIQI** u zgjodh kryeministër i Serbisë.

11. Më 22 shkurt 1994, **Nikolla SHAINOVIQI** u emërua zëvendëskryeministër i RFJ-së. Ai u riemërua në këtë post në tri qeveri me radhë: më 12 qershor 1996, më 20 mars 1997 dhe më 20 maj 1998. **Slobodan MILLOSHEVIQI** caktoi **Nikolla SHAINOVIQIN** si përfaqësues të tij për Kosovën. **Nikolla SHAINOVIQI** kryesoi komisionin për bashkëpunim me Misionin Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (më tej “OSBE”) në Kosovë dhe ishte anëtar zyrtar i delegacionit serb në bisedime për paqe në Rambuje në shkurt të vitit 1999. **Nikolla SHAINOVIQI** u tërhoq nga pozita e tij si zëvendëskryeministër i RFJ-së para datës ose më datën 4 nëntor 2000, kur u formua një qeveri e re federale. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Nikolla SHAINOVIQI** ishte në postin e zëvendëskryeministrit të RFJ-së.

12. **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** u lind më 1 qershor 1941 në fshatin Ravni afër Uzhicës, në Serbinë e sotme. Më 1958 ai mbaroi Shkollën e Këmbësorisë për Nënoficerë dhe më 1964 mbaroi Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore. Më 1985 Gjeneralkoloneli **Dragolub OJDANIQI** u diplomua në Akademinë e Shtabit të Komandës dhe në Fakultetin e Mbrojtjes Popullore me titullin e magjistrisë të shkencave ushtarake. Në një kohë shërbeu si sekretar i Lidhjes së Komunistëve të Korpusit të 52-të të Armatës Popullore Jugosllave (më tej “APJ”), paraardhëse e Korpusit të 52-të të Forcave të Armatosura të RFJ-së (më tej “UJ”).

13. Më 1992, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** ishte komandant i Korpusit të 37-të të APJ-së, më vonë të UJ-së, me bazë në Uzhicë, Serbi. Ai mori gradën e gjeneralmajorit më 20 prill 1992 dhe u bë komandant i Korpusit të Uzhicës. Nën komandën e tij, Korpusi i Uzhicës mori pjesë në veprime luftarake në Bosnjën lindore gjatë luftës në Republikën e Bosnjës e Hercegovinës (më tej “Bosnjë e Hercegovinë”). Në vitet 1993-1994, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** shërbeu si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Parë të UJ-së. Ai ishte komandant i Armatës së Parë në vitet 1994-1996. Më 1996 u bë zëvendës-shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. Më 24 nëntor 1998 **Slobodan MILLOSHEVIQI** emëroi **Gjeneralkolonelin Dragolub OJDANIQIN** shef të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në vend të Momçillo Perishiçit. **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** u emërua ministër federal i mbrojtjes më 15 shkurt 2000 dhe shërbeu në këtë post deri më 3 nëntor 2000. U nxor në pension nga shërbimi ushtarak me dekret presidencial më 30 dhjetor 2000. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Dragolub OJDANIQI** ishte në postin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.

14. **Vllajko STOJILKOVIQI** u lind në vitin 1937 në Malla Kërsna në Serbi. U diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit dhe pastaj u punësua në gjykatën komunale. Më vonë u bë drejtor i Sekretariatit Ndërkomunal të Punëve të Brendshme në Pozharevc. **Vllajko STOJILKOVIQI** shërbeu si drejtor i kompanisë *PIK* në Pozharevc, zëvendëskryetar dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të Jugosllavisë, si dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të Serbisë.

15. Para prillit të vitit 1997, **Vllajko STOJILKOVIQI** u bë zëvendëskryeministër i qeverisë së Serbisë dhe ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Më 24 mars

1998, Kuvendi i Serbisë zgjodhi një qeveri të re dhe **Vllajko STOJILKOVIQI** u emërua ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Ai është gjithashtu anëtar i Këshillit Drejtues të SPS-së. **Vllajko STOJILKOVIQI** dha dorëheqjen nga posti i tij si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë më 9 tetor 2000. Ai është deputet në Dhomën e Republikave të Kuvendit Federal. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Vllajko STOJILKOVIQI** ka qenë në postin e ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë.

PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

Neni 7 (1) i Statutit të Tribunalit

16. Secili prej të akuzuarve është përgjegjës individualisht për krimet për të cilat akuzohet në këtë aktakuzë nën Nenet 3, 5 dhe 7(1) të Statutit të Tribunalit. Të akuzuarit planifikuan, urdhëruan, kryen ose përndryshe ndihmuan planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtyre krimeve, Me përdorimin e fjalës “kryen” në këtë aktakuzë, Prokurorja nuk synon të nënkuptojë se ndonjëri prej të akuzuarve kreu fizikisht ndonjërin prej krimeve të akuzuara, personalisht. “Kryerja” në këtë aktakuzë i referohet pjesëmarrjes si bashkëkryes në një projekt të përbashkët kriminal. Qëllimi i këtij projekti të përbashkët kriminal ishte ndër të tjera dëbimi i një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare nga territori i krahinës së Kosovës, në përpjekje për të siguruar kontrollin e mëtejshëm serb mbi krahinën. Për të arritur këtë qëllim kriminal, secili prej të akuzuarve, duke vepruar si individ ose në ujdi me njëri-tjetrin ose me njërez të tjerë të njohur dhe të panjohur, i bëri një kontribut të dukshëm këtij projekti të përbashkët kriminal, duke i përdorur kompetencat *de jure* dhe *de facto* që i kishte në dispozicion.

17. Ky projekt i përbashkët kriminal filloi jo më vonë se në tetor të vitit 1998 dhe vazhdoi gjatë tërë periudhës në të cilën ndodhën krimet që përmenden në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze: duke filluar më datën ose rreth datës 1 janar 1999 dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 1999. Një numër individësh morën pjesë në këtë projekt të përbashkët kriminal gjatë tërë periudhës së ekzistimit të tij ose, përndryshe, në kohë të ndryshme gjatë periudhës së ekzistimit të tij, duke përfshirë **Sllobodan MILLOSHEVIQIN, Millan MILLUTINOVIQIN, Nikolla SHAINOVIQIN, Dragolub OJDANIQIN, Vllajko STOJILKOVIQIN** dhe të tjerë të njohur dhe të panjohur.

18. Krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze ishin pjesë të synimit të këtij projekti të përbashkët kriminal. Përndryshe, krimet e paraqitura në Pikat 3 deri në 5 ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të projektit të përbashkët kriminal dhe të akuzuarit dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur ishin të vetëdijshëm se krimet e tilla ishin rezultate që mund të priteshin nga projekti i përbashkët kriminal. **Sllobodan MILLOSHEVIQI, Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI, Vllajko STOJILKOVIQI** dhe njerëz të tjerë të njohur dhe të panjohur morën pjesë në mënyrë të vetëdijshme dhe të vullnetshme në projektin e përbashkët kriminal. Secili prej të akuzuarve dhe pjesëmarrësve të tjerë në projektin e përbashkët kriminal kishte qëllimin dhe gjendjen psikologjike të nevojshme për kryerjen e secilës prej krimeve të paraqitura në Pikat 1 deri në 5. Mbi këtë bazë, nën Nenin 7(1) të Statutit, secili prej të

akuzuarve dhe pjesëmarrësve të tjerë në projektin e përbashkët kriminal mban përgjegjësi individuale për krimet e paraqitura në Pikat 1 der në 5.

Neni 7(3) i Statutit të Tribunalit

19. **Slobodan MILLOSHEVIQI, Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI, Vllajko STOJILKOVIQI**, duke mbajtur poste me autoritet epror, gjithashtu mbajnë përgjegjësi penale për veprimet ose mosveprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit. Eprori mban përgjegjësi penale për veprimet kriminale të vartësve të vet në qoftë se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit do të kryenin veprime të tilla ose i kishin kryer dhe eprori nuk kishte marrë masat e domsdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar vepra të tilla ose për t'i ndëshkuar kryesit e tyre.

20. **Slobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i RFJ-së më 15 korrik 1997 dhe filloi detyrën më 23 korrik 1997. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ai ka mbajtur postin e kryetarit të RFJ-së.

21. Si kryetar i RFJ-së, **Slobodan MILLOSHEVIQI** ishte edhe kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së. Këshilli Suprem i Mbrojtjes përbëhet nga kryetari i RFJ-së dhe kryetarët e republikave anëtare, Serbia dhe Mali i Zi. Këshilli Suprem i Mbrojtjes vendos për Planin e Mbrojtjes Kombëtare dhe shpall vendime lidhur me UJ-në. Si kryetar i RFJ-së, **Slobodan MILLOSHEVIQI** kishte kompetencë për të urdhëruar zbatimin e Planit Kombëtar të Mbrojtjes dhe komandoi UJ-në në luftë dhe në paqe në bazë të vendimeve të Këshillit Suprem të Mbrojtjes. **Slobodan MILLOSHEVIQI**, si komandant suprem i UJ-së, kreu këto detyra nëpërmjet komandimeve, urdhrave dhe vendimeve.

22. Sipas Ligjit mbi Mbrojtjen të RFJ-së, **Slobodan MILLOSHEVIQI** si komandant suprem i UJ-së gjithashtu ushtronte autoritet komandues mbi njësitet policore republikane dhe federale, të cilat viheshin në vartësi të UJ-së në gjendje luftime apo në gjendje të kanosjes së afërt të luftës. Deklarata e kanosjes së afërt të luftës u shpall më 23 mars 1999, ndërsa ajo e gjendjes së luftës më 24 mars 1999.

23. Përpos kompetencave të tij *de jure*, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Slobodan MILLOSHEVIQI** ushtronte kontroll të gjerë *de facto* mbi shumë institucione me rëndësi thelbësore për kryerjen e krimeve që përmenden në këtë aktakuzë, apo që ishin të përfshira në kryerjen e këtyre krimeve. **Slobodan MILLOSHEVIQI** ushtronte kontroll të gjerë *de facto* mbi institucione federale që formalisht janë nën kompetencat e Kuvendit apo të Qeverisë së RFJ-së. **Slobodan MILLOSHEVIQI** gjithashtu ushtronte kontroll *de facto* mbi funksione dhe institucione që formalisht janë nën kompetencat e Serbisë dhe të krahinave autonome, duke përfshirë policinë e Serbisë. **Slobodan MILLOSHEVIQI** gjithashtu ushtronte kontroll *de facto* mbi shumë lëmenj të jetës politike dhe ekonomike të RFJ-së, veçanërisht mbi mjetet e informimit. Prej vitit 1986 deri në fillim të viteve 90, **Slobodan MILLOSHEVIQI** gjithnjë e më shumë mori nën kontroll *de facto* këto institucione federale, republikane dhe krahinore dhe institucione të tjera.

24. Kontrolli *de facto* i **Sllobodan MILLOSHEVIQIT** mbi organet e Serbisë, të RSFJ-së dhe të RFJ-së dhe mbi organe të tjera shtetërore rrodhi pjesërisht nga udhëheqja prej tij e të dyja partive politike kryesore të cilat kanë qenë në pushtet në Serbi prej vitit 1986 deri në 2000 dhe në RFJ prej vitit 1992 deri në 2000. Prej vitit 1986 deri më 1990 ai ishte kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, atëbotë partia në pushtet në Serbi. Në vitin 1990, ai u zgjodh Kryetar i Partisë Socialiste të Serbisë, partia pasardhëse e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës së Serbisë. Gjatë periudhës së tij si kryetar i Serbisë, prej 1990 deri më 1997, dhe si kryetar i RFJ-së prej vitit 1997 deri në vitin 2000, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ishte edhe udhëheqës i SPS-së.

25. Të paktën që nga tetori i vitit 1988 dhe gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ushtroi kontroll *de facto* mbi institucionet në pushtet dhe ato qeveritare të Serbisë, duke përfshirë MPB-në. Të paktën që nga tetori i vitit 1988, ai ushtroi kontroll *de facto* mbi të dyja krahinat autonome të Serbisë – Kosovë dhe Vojvodinë – dhe mbi përfaqësimin e tyre në organet federale të RSFJ-së dhe RFJ-së. Të paktën që nga tetori i vitit 1988 deri në mesin e vitit 1998, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka ushtruar gjithashtu kontroll *de facto* mbi institucionet në pushtet dhe ato qeveritare të Republikës së Malit të Zi (më tej “Mali i Zi”), duke përfshirë përfaqësimin e Malit të Zi në të gjitha organet federale të RSFJ-së dhe të RFJ-së.

26. Prej vitit 1989 dhe gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ishte bashkëbiseduesi kryesor i bashkësisë ndërkombëtare në negociata, takime, dhe konferenca të rëndësishme ndërkombëtare. Me të u arritën marrëveshjet ndërkombëtare të cilat më vonë u zbatuan brenda Serbisë, RSFJ-së, RFJ-së, dhe gjetkë në territorin e RSFJ-së. Ndër konferencat dhe negociatat ndërkombëtare në të cilat përfaqësues kryesor i RSFJ-së dhe RFJ-së ishte **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ishin: Konferenca e Hagës më 1991; negociatat e Parisit në mars 1993; Konferenca Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në janar 1993; negociatat për planin e paqes Vens-Ouen prej janarit deri në maj të vitit 1993; bisedimet për paqe në Gjenevë në verën e vitit 1993; mbledhja e Grupit të Kontaktit në qershor të vitit 1994; negociatat për një armëpushim në Bosnjë e Hercegovinë prej 9 deri më 14 shtator 1995; negociatat për t’u dhënë fund bombardimeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Bosnjë e Hercegovinë prej 14 deri më 20 shtator 1995; dhe negociatat për paqe në Dejton në nëntor të vitit 1995.

27. Si kryetar i RFJ-së, komandant suprem i UJ-së, kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe në bazë të autoritetit të tij *de facto*, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet brenda forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, të cilat përfshinin, ndër të tjera, UJ-në, Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë (më tej “MPB”), njësitë ushtarake-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile dhe grupe të tjera të armatosura që vepronin nën autoritetin ose me dijen e të tre të akuzuarve dhe personave të tjerë të njohur dhe të panjohur ose të vartësve të tyre që kryen krimet e paraqitura në pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze.

28. **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, si kryetar i RFJ-së, komandant suprem i UJ-së, kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit,

duke përfshirë, ndër të tjerë, anëtarë të UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të forcave të tjera të RFJ-së dhe të Serbisë për krimet e përmendura në pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze. Për më tepër, **Sillobodan MILLOSHEVIQI**, në bazë të autoritetit të tij *de facto*, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë ndër të tjerë anëtarë të UJ-së dhe personelin e MPB-së për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze.

29. **Millan MILLUTINOVIQI** u zgjodh kryetar i Serbisë më 21 dhjetor 1997 dhe vazhdon të jetë kryetar më datën e kësaj aktakuze. Si kryetar i Serbisë, **Millan MILLUTINOVIQI**, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ishte kryetar shteti. Ai përfaqëson Serbinë dhe udhëheq marrëdhëniet e Serbisë me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare. Ai organizon përgatitjet për mbrojtjen e Serbisë.

30. Si kryetar i Serbisë, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Millan MILLUTINOVIQI** ishte anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së dhe mori pjesë në vendime lidhur me përdorimin e UJ-së.

31. Si kryetar i Serbisë, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Millan MILLUTINOVIQI**, bashkë me Kuvendin e Republikës së Serbisë, kishte autoritetin për të kërkuar raporte si nga qeveria e Serbisë, lidhur me çështje nën juridiksionin e saj, ashtu dhe nga MPB-ja, lidhur me aktivitetet a saj dhe gjendjen e sigurisë në Serbi. Si kryetar i Serbisë, **Millan MILLUTINOVIQI** kishte autoritetin për të shpërndarë Kuvendin dhe qeverinë bashkë me të, “sipas propozimit të qeverisë dhe me arsye të justifikuara,” edhe pse ky pushtet vlen vetëm në kohë paqeje.

32. Gjatë gjendjes së luftës së shpallur apo gjendjes së kanosjes së afërt të luftës, **Millan MILLUTINOVIQI**, si kryetar i Serbisë, kishte mundësi të merrte masat që normalisht janë nën kompetencat e Kuvendit të Republikës së Serbisë, duke përfshirë miratimin e ligjeve; këto masa mund të përfshinin riorganizimin e qeverisë dhe të ministrive si edhe kufizimin e disa të drejtave dhe lirive.

33. Përpos kompetencave të tij *de jure*, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Millan MILLUTINOVIQI** ushtronte ndikim apo kontroll të gjerë *de facto* mbi shumë institucione që për kryerjen e krimeve që paraqiten këtu, ishin esenciale, apo edhe të përfshira në to. **Millan MILLUTINOVIQI** ushtronte ndikim apo kontroll *de facto* mbi funksione dhe institucione që teknikisht ishin nën kompetencat e qeverisë dhe Kuvendit të Serbisë dhe të krahinave autonome të saj, duke përfshirë policinë e Serbisë por pa u kufizuar vetëm me të.

34. Prej vitit 1995 dhe gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Millan MILLUTINOVIQI** ishte një bashkëbisedues kryesor me të cilin bashkësia ndërkombëtare negocioi. Ndër konferencat dhe negociatat ndërkombëtare në të cilat **Millan MILLUTINOVIQI** ishte një përfaqësues parësor i RFJ-së janë: negociatat paraprake për një armëpushim në Bosnjë e Hercegovinë prej 15 deri më 21 gusht 1995; takimet e Gjenevës lidhur me armëpushimin e Bosnjës më 7 shtator 1995; negociatat e mëtejshme për një armëpushim në Bosnjë e Hercegovinë prej 9 deri më 14 shtator 1995; negociatat për t'u dhënë fund bombardimeve të NATO-s në Bosnjë e Hercegovinë prej 14 deri më 20 shtator 1995; dhe negociatat e paqes në Dejton në

nëntor të vitit 1995. **Millan MILLUTINOVIQI** gjithashtu ka qenë i pranishëm në negociatat e Rambujesë në shkurt të vitit 1999.

35. Nën Ligjin mbi Mbrojtjen të RFJ-së, **Millan MILLUTINOVIQI**, si anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes, gjithashtu ushtronte autoritetin komandues mbi njësitet policore republikane në vartësi të UJ-së në gjendje lufte apo në gjendje të kanosjes së afërt të luftës. Deklarata e kanosjes së afërt të luftës u shpall më 23 mars 1999, ndërsa ajo e gjendjes së luftës më 24 mars 1999.

36. Si kryetar i Serbisë dhe anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes, **Millan MILLUTINOVIQI** mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të tij, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Trinbunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, anëtarë të UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të forcave të tjera të RFJ-së dhe të Serbisë, për krimet e paraqitura në këtë aktakuzë. Për më tepër, **Millan MILLUTINOVIQI**, në bazë të autoritetit të tij *de facto*, mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të tij, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, anëtarë të UJ-së dhe personelin e MPB-së, për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze.

37. **Nikolla SHAINOVIQI** u riemërua zëvendëskryeministër i RFJ-së më 20 maj 1998, Si i tillë, ai ishte anëtar i qeverisë së RFJ-së, e cila, ndër detyra dhe përgjegjësi të tjera, formulonte politikën e brendshme dhe të jashtme, zbatonte ligjin federal, drejtonte dhe bashkërendonte punën e ministrive federale dhe organizonte përgatitje për mbrojtje.

38. Para dhjetorit të vitit 1998, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** caktoi **Nikolla SHAINOVIQIN** si përfaqësues të tij për Kosovën. Një numër diplomatësh dhe zyrtarësh ndërkombëtarë të tjerë që kishin nevojë të flisnin me një zyrtar të qeverisë lidhur me ngjarjet në Kosovë iu drejtuan **Nikolla SHAINOVIQIT**. Ai luajti një rol aktiv në negociatat që e ngritën Misionin Verifikues të OSBE-së dhe ai mori pjesë në shumë takime të tjera lidhur me krizën në Kosovë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Nikolla SHAINOVIQI** ishte ndërlidhës ndërmjet **Sllobodan MILLOSHEVIQIT** dhe disa udhëheqësve të shqiptarëve të Kosovës. Në bazë të pozitës së tij si zëvendëskryeministër i RFJ-së dhe rolit të tij si përfaqësues i caktuar nga **Sllobodan MILLOSHEVIQI** për Kosovën, **Nikolla SHAINOVIQI** ushtronte kontroll efektiv mbi shumë individë dhe institucione që ishin me rendësi për kryerjen e krimeve të paraqitura këtu, të përfshirë në to, ose përgjegjës për to.

39. **Nikolla SHAINOVIQI**, në bazë të autoritetit të tij *de facto*, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për krimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, anëtarë të UJ-së dhe personelin e MPB-së, për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze.

40. **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 24 nëntor 1998. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ai mbajti postin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** komandonte, urdhëronte, udhëzonte, rregullonte dhe për ndryshe drejtonte UJ-në, në bazë të akteve të lëshuara nga kryetari i RFJ-së dhe sipas nevojës për komandimin e UJ-së.

41. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** përcaktoi organizimin, planin e zhvillimit dhe formimin e komandave, njësiteve dhe institucioneve të UJ-së, në përputhje me karakterin dhe nevojat e UJ-së dhe në bazë të akteve të sjella nga kryetari i RFJ-së.

42. Me autoritetin e pozitës së tij, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** gjithashtu përcaktonte planin për rekrutimin dhe plotësimin e posteve të lira në UJ dhe për shpërndarjen e rekrutëve brenda saj; lëshonte rregullore që kishin të bënin me stërvitjen e UJ-së; përcaktonte planin arsimor dhe përgatitjen e lartë të oficerëve ushtarakë profesionistë dhe rezervistë; dhe kryente detyra të tjera të caktuara me ligj.

43. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** -- apo oficerë të tjerë të cilëve u ka dhënë autorizim – caktonte oficerë, nënoficerë dhe ushtarë në detyrë. Ai gradonte nënoficerë, oficerë rezervistë dhe oficerë deri në rangun e kolonelit. **Gjeneralkoloneli Dragoljub OJDANIQI** gjithashtu emëronte kryetarë të gjyqeve, gjykatës, prokurorë dhe zëvendës e sekretarë të tyre, për të shërbyer nëpër gjyqe disiplinore ushtarake.

44. **Gjeneralkoloneli Dragoljub OJDANIQI** kryente përgatitje për thirrje në ushtri të qytetarëve dhe mobilizimin e UJ-së; ai bashkëpunonte me Ministrinë e Punëve të Brendshme të RFJ-së dhe të Serbisë dhe me Ministrinë e Mbrojtjes të RFJ-së, duke mobilizuar organet dhe njësitet e Ministrisë së Punëve të Brendshme; mbikëqyrte dhe propozonte masa për të korrigjuar probleme që haseshin gjatë këtij mobilizimi dhe informonte qeverinë e RFJ-së dhe Këshillin Suprem të Mbrojtjes rreth zbatimit të tij.

45. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI**, nën Ligjin e Mbrojtjes të RFJ-së gjithashtu ushtronte autoritetin e komandës mbi njësitet policore republikane që u vunë në vartësi të Armatës së Tretë të UJ-së gjatë gjendjes së luftës apo kanosjes së afërt të luftës. Deklarata e kanosjes së afërt të luftës u shpall më 23 mars 1999, ndërsa ajo e gjendjes së luftës më 24 mars 1999.

46. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI**, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, anëtarë të UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të forcave të tjera të RFJ-së dhe të Serbisë, për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze. Për më tepër, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI**, në bazë të autoritetit të tij *de facto*, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, anëtarë të UJ-së dhe të punësuarit e MPB-së, për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze.

47. **Vllajko STOJILKOVIQI** u emërua ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë më 24 mars 1998. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Vllajko STOJILKOVIQI** mbante postin e ministrit të punëve të brendshme të Serbisë. Si titullar i një ministrie të qeverisë serbe, **Vllajko STOJILKOVIQI** ishte përgjegjës për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe të akteve të përgjithshme të nxjerra nga Kuvendi, qeveria, apo kryetari i Serbisë.

48. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI** drejtonte punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe personelin e saj. Ai përcaktonte strukturën, mandatin dhe fushëveprimin e operacioneve të njësiteve të organizuara brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai kishte kompetenca të thirrte anëtarët e korpusit rezervist të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kryer detyrat në kohën e paqes dhe për të parandaluar veprime që kërcënonin sigurinë e Serbisë. Urdhërat të cilat ai dhe oficerët e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme i dhanë personelit të Ministrisë së Brendshme ishin të detyrueshme, përveç në ato raste kur përbënin një veprim kriminal.

49. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI** kishte kompetencat për të rishikuar vendimet dhe veprimet e personelit të Ministrisë. Ai shqyrtonte ankesa kundër vendimeve të marra në instancën e parë nga shefi i një njësi të organizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai kishte gjithashtu kompetenca për të vendosur për ankesat e individëve që mbaheshin në arrest nga policia.

50. Më 8 prill 1999, kompetencat e **Vllajko STOJILKOVIQIT** si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë u zgjeruan për të përfshirë transferimin e personelit të Ministrisë në detyra të ndryshme brenda Ministrisë për sa kohë që të ishte e nevojshme.

51. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI** ishte përgjegjës për ruajtjen e ligjit dhe rendit në Serbi

52. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI**, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, të punësuarit e MPB-së dhe personelin e lartpërmendur të forcave të tjera të RFJ-së dhe të Serbisë, për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze. Për më tepër, **Vllajko STOJILKOVIQI**, në bazë të autoritetit të tij *de facto*, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit, duke përfshirë, ndër të tjerë, të punësuarit e MPB-së, për krimet e paraqitura në Pikat 1 deri në 5 të kësaj aktakuze.

AKUZAT

53. Pas nisjes së projektit të përbashkët kriminal, duke filluar më 1 janar të vitit 1999 ose rreth kësaj date, dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 2000, **Sillobodan MILLOSHEVIQI; Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI, Vllajko STOJILKOVIQI** dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur, planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen, apo ndihmuan në ndonjë mënyrë tjetër, një fushatë terrori dhe dhune të qëllimshme, të gjerë ose sistematike të drejtuar kundër civilëve shqiptarë të Kosovës me banim në Kosovë, në RFJ.

54. Fushata e terrorit dhe e dhunës e qëllimshme, e gjerë ose sistematike, e drejtuar kundër popullatës shqiptare të Kosovës, u krye nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë që vepronin nën drejtimin dhe me nxitjen, apo përkrahjen e **Sillobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT** dhe **Vllajko STOJILKOVIQIT** dhe personave të tjerë të njohur dhe të panjohur. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërmorën veprimet kundër shqiptarëve të Kosovës me qëllim që të dëbohet nga Kosova një pjesë e konsiderueshme e popullatës shqiptare të Kosovës në përpjekje për të siguruar kontroll të mëtejshëm serb mbi krahinën. Për të arritur këtë qëllim, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar në bashkëpunim, ndërmorën veprime të përgatitura dhe të bashkërenditura mirë, të përshkruara në paragrafet 55 deri në 61 më poshtë.

55. Në mënyrë të qëllimshme, të gjerë, ose sistematike, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dëbuan me dhunë dhe zhvendosën brenda vendit qindra mijëra shqiptarë të Kosovës nga shtëpitë e tyre në mbarë krahinën e Kosovës. Për të kryer në mënyrë më të lehtë këto dëbime dhe zhvendosje, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht krijuan një atmosferë frike dhe shtypjeje me anë të forcës, me kërcënime për përdorimin e forcës dhe me akte dhune.

56. Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërmorën një fushatë të qëllimshme, të gjerë ose sistematike për të shkatërruar pasurinë e civilëve shqiptarë të Kosovës. Kjo fushatë u krye me granatimin intensiv të qyteteve dhe të fshatrave; me djegien dhe shkatërrimin e pronës, duke përfshirë shtëpi, ferma, objekte ekonomike, monumente kulturore dhe objekte fetare; si dhe me shkatërrim të pasurisë personale. Si pasojë e këtyre veprimeve të bashkërenditura, fshatra, qytete dhe rajone të tëra u bënë të pabanueshme për shqiptarë të Kosovës.

57. Bashkë me shkatërrimin e qëllimshëm të pronës së civilëve shqiptarë të Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kryen veprime të vrazhda dhe të dhunshme në një shkallë të gjerë ose sistematike kundër civilëve shqiptarë të Kosovës me qëllim që ta zgjatnin atmosferën e frikës dhe për të mbjellë kaos dhe një frikë të gjithanshme për jetë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin fshat për fshat dhe, nëpër qytete, lagje për lagje, duke kërcënuar dhe dëbuar popullatën shqiptare të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës shpesh u ngacmuan, u sulmuan ose u vranë publikisht për të detyruar familjet dhe fqinjët e tyre që të largoheshin. Shumë shqiptarë të Kosovës që nuk u dëbuan nga vendbanimet e tyre me dhunë të drejtpërdrejtë ikën për shkak të atmosferës së terrorit që u krijua nga rrahjet, ngacmimet, sulmet seksuale, arrestimet e paligjshme, vrasjet, granatimet dhe plaçkitja që u kryen anëmbanë krahinës në një shkallë të gjerë ose sistematike. Shqiptarët e Kosovës iu nënshtruan vazhdimisht sharjeve dhe fyerjeve raciste nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, poshtërimeve dhe keqtrajttimeve të tjera fizike dhe psikologjike në bazë të përkatësisë së tyre raciale,

fetare dhe politike. Të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare të Kosovës u zhvendosën, duke përfshirë gra, fëmijë, pleq, dhe shëndetligj.

58. Mijëra shqiptarë kosovarë të cilët ikën nga shtëpitë e tyre për shkak të sjelljes së forcave të RFJ-së dhe të Serbisë dhe atmosferës së qëllimshme të terrorit që kaploi territorin e Kosovës iu bashkuan kolonave të njerëzve të cilët iu drejtuan kufijve të Kosovës me Republikën e Shqipërisë (më tej “Shqipëria”) dhe me Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë (më tej “Maqedonia”). Gjatë rrugëve deri në vendkalimet kufitare, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë mbanin postblloqe ku shqiptarët kosovarë të zhvendosur iu nënshtruan rrahjeve, zhvatjes, vjedhjes, ngacmimit, sulmeve, arrestimeve të paligjshme dhe vrasjeve. Në kohë të tjera, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përcollën grupe të shqiptarëve kosovarë të zhvendosur deri në kufi. Shqiptarët kosovarë të zhvendosur shpesh erdhën në kufijtë e Kosovës me këmbë në kolona prej disa mijëra njerëzish ose me traktorë, rimorkio dhe kamione, si edhe me trena, autobusë ose kamionë të cilët u organizuan dhe u furnizuan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.

59. Për më tepër, mijëra shqiptarë kosovarë të cilët ikën nga shtëpitë e tyre dhe kështu u transferuan me dhunë si pasojë e veprimeve të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë dhe si pasojë e tërë atmosferës së qëllimshme të terrorit e cila përshkoi territorin e Kosovës, u detyruan të kërkonin strehim për ditë, me javë ose muaj me radhë në qytete dhe fshatra të tjera dhe/ose në pyje dhe male anembanë krahinës. Disa nga këta njerëz të zhvendosur brenda vendit qendruan brenda krahinës së Kosovës gjatë tërë periudhës që lidhet me këtë aktakuzë dhe shumë njerëz vdiqën si pasojë e kushteve klimatike të ashpra, ushqimit të mangët, kujdesit mjekësor të mangët, dhe rraskapitjes. Të tjerët më në fund kaluan ndonjërin prej kufijve të Kosovës me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, ose kufirin krahinor midis Kosovës dhe Serbisë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjet e shumë shqiptarëve të Kosovës, të zhvendosur brenda vendit, deri në dëbimin e tyre përfundimtar nga Kosova.

60. Anembanë Kosovës, në një përpjekje të qëllimshme dhe të gjerë ose sistematike që të pengonin shqiptarë kosovarë të dëbuar të ktheheshin në shtëpi të tyre, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë plaçkitën dhe grabitën pronën personale dhe komerciale të shqiptarëve kosovarë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u vodhën shqiptarëve kosovarë të hollat dhe artikuj me vlerë me anë të bastisjeve masive, kërcënimeve të dhunës, dhe akteve të dhunës, dhe autoritetet në postet kufitare të RFJ-së, në një shkallë të gjerë ose sistematike, ua vodhën automjetet personale dhe pasuritë e tjera shqiptarëve të Kosovës që dëboheshin nga krahina.

61. Për më tepër, anembanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike konfiskuan dhe shkatërruan dokumentet personale të identifikimit dhe targat e automjeteve të shqiptarëve civilë të Kosovës. Derisa shqiptarët e Kosovës po dëboheshin nga shtëpitë dhe drejtoheshin drejt kufijve të Kosovës, ata u nënshtroheshin kërkesave që të dorëzonin letërnjoftimet në pika të veçanta gjatë rrugës për në kufi dhe në vendkalimet kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Këto veprime u bënë me qëllim për të fshirë çdo gjurmë të pranisë së shqiptarëve kosovarë në Kosovë dhe për t’ua mohuar të drejtën për t’u kthyer në shtëpitë e tyre.

PIKA 1

DËBIMI

62. Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 55 – 61. duke iu referuar atyre.

63. Duke filluar nga 1 janari 1999 apo rreth kësaj dite e deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo përkrahjen e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT, Vllajko STOJILKOVIQIT** dhe personave të tjerë të njohur dhe të panjohur, kanë kryer veprimet e parashtruara në paragrafet 55 deri në 61, duke shkaktuar deportimin e dhunshëm të rreth 800,000 shqiptarëve civilë të Kosovës. Që të kryhen më lehtë këto debime dhe zhvendosje, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht krijuan një atmosferë frike dhe shtypjeje, si përshkruhet në paragrafet 55 deri në 61. Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht granatuan qytete dhe fshatra, dogjën shtëpi dhe ferma, dëmtuan dhe shkatërruan institucione kulturore dhe fetare të shqiptarëve të Kosovës, vranë shqiptarë civilë kosovarë dhe kryen sulme seksuale mbi gra shqiptare të Kosovës. Këto veprime u ndërmorën në të gjitha viset e Kosovës dhe këto mjete dhe metoda të qëllimshme janë përdorur anëmbanë krahinës, duke përfshirë këto komuna:

a) Rahovec: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Celinë me tanke dhe autobllinda. Pasi granatuan fshatin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat dhe sistematikisht plaçkitën dhe grabitën çdo artikull me vlerë nga shtëpitë, iu futën zjarr shtëpive dhe dyqaneve dhe shkatërruan xhaminë e vjetër.. Shumica e fshatarëve shqiptarë të Kosovës kishin ikur në një pyll të afërt para ardhjes së ushtrisë dhe policisë. Më 28 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë detyruan mijëra njerëz që ishin strehuar në pyll të dilnin prej aty. Civilët u detyruan të marshonin deri në një fshat të afërt, ku u ndanë burrat nga gratë. Meshkujt u rrahën, u plaçkitën, dhe atyre ua morën të gjitha letërnjoftimet. Meshkujt pastaj u detyruan të marshonin me këmbë për në Prizren dhe më në fund u detyruan të shkonin në Shqipëri.

(i) Më 25 mars 1999, një grup i madh shqiptarësh të Kosovës shkuan në një mal afër fshatit Nagafc, gjithashtu në komunën e Rahovecit, duke kërkuar siguri prej sulmeve mbi fshatrat përreth. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rrethuan dhe të nesërmen i urdhëruan të 8,000 njerëzit që kishin kërkuar strehim në mal të largoheshin. Shqiptarët kosovare u detyruan të shkonin në një shkollë aty afër dhe pastaj u shpërndanë me forcë nëpër fshatrat përreth. Pas tri apo katër ditësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatra, shkuan shtëpi për shtëpi dhe urdhëruan njerëzit të dilnin jashtë. Më në fund, këta njerëz u kthyen me forcë në shtëpi dhe u urdhëruan që të mos dilnin. Ata për të cilët nuk kishte vend nëpër shtëpi u detyruan të rrinin në vetura dhe në traktorët që ishin parkuar aty afër. Më 2 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të granatonin fshatrat, duke vranë një numër njerëzish që po flinin nëpër traktorë dhe vetura. Ata që mbetën gjallë ia mësynë kufirit me Shqipërinë. Tek kalonin

nëpër fshatra të tjera të shkatërruara të shqiptarëve të Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i ngacmuan. Kur arritën në kufi, fshatarëve ua morën të gjitha letërnjoftimet. Gjatë debimeve, në tërë komunën e Rahovecit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike dogjën shtëpi, dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare që u takonin shqiptarëve kosovarë. Disa xhami u shkatërruan, duke përfshirë xhamitë e Bellacërkës, Brestofcit, Krushës së Madhe, dhe të tjera.

b. Prizren: Më 25 mars 1999, fshati Piranë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë me tanke dhe llojloj automjeteve ushtarake. Fshati është granatuar dhe një numër banorësh janë vrarë. Pastaj policët hynë në fshat dhe i dogjën shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës. Pas sulmit, fshatarët e mbetur u larguan nga Pirana dhe shkuan në fshatrat përreth. Në fshatin Landovicë, një xhami e vjetër u dogj dhe u dëmtua rëndë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Disa prej shqiptarëve të Kosovës, duke ikur në drejtim të Sërbicës, u vranë apo u plagosën nga snajperët. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj filluan një ofensivë në rrethinën e Sërbicës, duke granatuar fshatrat Reti e Ulët, Reti, dhe Randobravë. Fshatarët shqiptarë kosovarë u përzunë nga shtëpitë dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë. Prej 28 marsit 1999 në qytetin e Prizrenit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi për shtëpi, duke urdhëruar banorët shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Ata u detyruan t'u bashkoheshin kolonave të automjeteve dhe të njerëzve që udhëtonin në këmbë drejt kufirit shqiptar. Gjatë rrugës, anëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë rrahën dhe vranë meshkuj kosovarë shqiptarë, ndanë gra kosovare shqiptare nga kolona. dhe i sulmuan gratë seksualisht. Në kufi, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë morën të gjitha dokumentet personale.

c. Skënderaj: Duke filluar më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan dhe shkatërruan me anë të granatimeve dhe djegies fshatrat Vojnikë, Leçinë, Klladernicë, Turuçec dhe Izbicë. Shumë shtëpi, dyqane dhe xhami u shkatërruan, duke përfshirë xhaminë në qendrën e fshatit Qirez. Disa gra dhe fëmijë u morën nga anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë dhe u mbajtën në një hambar në Qirez. Gratë iu nënshtruan sulmit seksual dhe atyre iu vodhën të hollat dhe pronat. Së paku tetë prej grave u vranë pasi që u sulmuan seksualisht dhe kufomat e tyre u hodhën në tri puse në fshatin Qirez. Më 28 mars 1999 apo rreth kësaj date, së paku 4,500 shqiptarë të Kosovës prej këtyre fshatrave u mblodhën në fshatin Izbicë, ku pjesëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë kërkuan të holla prej këtyre shqiptarëve të Kosovës dhe i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Një numër i madh i burrave pastaj u vranë. Gratë dhe fëmijët në grup u çuan me dhunë në drejtim të Klinës, të Gjakovës dhe me në fund në kufirin me Shqipërinë.

d. Suharekë: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan qytetin e Suharekës. Gjatë këtyre ditëve, policët shkonin shtëpi për shtëpi, duke kërcënuar dhe sulmuar dhe duke vrarë banorët shqiptarë të Kosovës dhe duke nxjerrë shumë njerëz nga shtëpitë e tyre nën tytën e pushkës. Shumë shtëpive dhe dyqaneve, që ishin pronë të shqiptarëve të Kosovës, u është vënë zjarri dhe një xhami në Suharekë

është dëmtuar. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u larguan nga policia dhe pastaj një numër burrash u vranë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të iknin me kamionë, traktorë dhe rimorkio drejt kufirit me Shqipërinë. Tek kalonin kufirin, u janë marrë të gjitha dokumentet dhe të hollat.

(i) Më 31 mars 1999, rreth 80,000 shqiptarë të Kosovës të zhvendosur nga fshatrat e komunës së Suharekës u mblodhën afër Bellanicës. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e granatuan Bellanicën, duke detyruar të zhvendosurit të iknin drejt kufirit shqiptar. Para se të kalonin kufirin, u janë marrë të gjitha letërnjoftimet.

(e) Pejë: Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth këtrye datave, në qytetin e Pejës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi për shtëpi duke detyruar shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Disa shtëpive iu vu zjarri dhe disa njerëz u pushkatuan. Ushtarë dhe policë u vendosën në çdo rrugë, duke i drejtuar shqiptarët e Kosovës drejt qendrës së qytetit. Kur erdhën njerëzit në qendrën e qytetit, ata pa vetura apo mjete transporti u detyruan të hypnin nëpër autobusë apo kamionë dhe u çuan në qytetin e Prizrenit. Në hyrje të qytetit të Prizrenit, shqiptarët e Kosovës u detyruan të zbritnin prej autobusëve dhe të ecnin rreth 15 kilometra deri në kufirin me Shqipërinë, ku u urdhëruan t'u dorëzonin letërnjoftimet forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.

(f) Mitrovicë: Duke filluar më 25 mars 1999 ose rreth kësaj date, dhe duke vazhduar gjatë mesit të prillit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të lëviznin sistematikisht nëpër qytetin e Mitrovicës. Ata hynin nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe urdhëronin banorët që t'i lëshonin menjëherë shtëpitë dhe të shkonin në stacionin e autobusëve. Disa shtëpive u është vënë zjarri, kështuqë banorët u detyruan të iknin në lagje të tjera të qytetit. Së paku njëra prej xhamive të qytetit u dogj dhe u dëmtua. Gjatë një periudhe trijavore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhduan të dëbonin banorët shqiptarë kosovarë të qytetit. Gjatë kësaj periudhe, objektet që ishin pronë e shqiptarëve të Kosovës u shkatërruan dhe shqiptarëve kosovarë u janë plaçkitur të holla, automjete dhe artikuj të tjerë me vlerë. Gratë shqiptare të Kosovës janë sulmuar seksualisht. Metodot e ngjashme janë zbatuar në fshatrat e tjera të komunës së Mitrovicës: forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i nxorën shqiptarët e Kosovës nga shtëpitë dhe i shkatërruan fshatrat. Banorët shqiptarë kosovarë të kësaj komune u detyruan t'u bashkoheshin kolonave drejt kufirit me Shqipërinë nëpër qytetet e Skënderajt, Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit. Gjatë rrugës për në kufi, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u plaçkitën artikuj me vlerë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet.

(g) Prishtinë: Duke filluar më 24 mars 1999 apo rreth kësaj date dhe duke vazhduar deri në fund të majit të vitit 1999, policët serbë shkonin në shtëpitë e shqiptarëve kosovarë në qytetin e Prishtinës dhe i detyronin banorët që të largoheshin. Gjatë këtyre dëbimeve me forcë, një numër njerëzish janë vranë. Shumë prej të dëbuarve shkuan drejt në stacionin e trenave, derisa të tjerët kërkuan strehim në lagje të tjera të afërta. Qindra shqiptarë etnikë, të cilëve policët serbë ua tregonin udhën në çdo

udhëkryq, u mblodhën në stacionin e trenave dhe pastaj u futën në trena dhe në autobusë të stërmblodhur pas një pritjeje të gjatë, gjatë së cilës nuk u është dhënë ujë apo ushqim. Ata në tren u çuan deri në Han të Elezit, fshat afër kufirit me Maqedoninë. Gjatë udhëtimit me tren, shumë njerëzve u janë marrë letërnjoftimet. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u thanë shqiptarëve të Kosovës, pasi zbritën nga trenat, të ecnin nëpër binarë deri në Maqedoni, sepse toka përreth ishte e minuar. Ata që kërkonin të fshiheshin në Prishtinë u dëbuan në një mënyrë të ngjashme disa ditë më vonë. Gjatë këtyre dëbimeve me dhunë, një numër njerëzish janë vrarë dhe disa gra janë sulmuar seksualisht.

(i) Gjatë po kësaj periudhe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynin në fshatrat e komunës së Prishtinës, ku ata rrahën dhe vranë shumë shqiptarë kosovarë, duke ua plaçkitur të hollat dhe pasurinë dhe duke ua djegur shtëpitë. Shumë prej fshatarëve u çuan me kamion në Glllogoc të komunës së Lipjanit. Nga andej janë transportuar në Han të Elezit me tren dhe kanë ecur deri në kufirin me Maqedoninë. Të tjerët, pasi arritën në qytetin e Ferizajit, morën urdhra nga policia serbe të hypnin në tren për në Han të Elezit, nga kaluan në këmbë kufirin me Maqedoninë.

h. Gjakovë: Në mars të vitit 1999, popullsia e qytetit të Gjakovës ishte rritur dukshëm për shkak të ardhjes së një numri të madh njerëzish të zhvendosur brenda vendit, të cilët kishin dalë nga fshatrat e tyre për t'i ikur granatimit të qëllimshëm të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë gjatë vitit 1998 dhe për t'i ikur konfliktit të armatosur midis këtyre forcave dhe anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lëvizja e vazhdueshme e këtyre njerëzve është rritur pas datës 24 mars 1999, kur, pas dëbimeve me dhunë nga qyteti i Gjakovës, shumë njerëz të zhvendosur brenda vendit u kthyen nga qyteti i Gjakovës në fshatra përreth, por u dëbuan përsëri prej këtyre fshatrave nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Forcat serbe kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjen e këtyre njerëzve të zhvendosur brenda vendit tek udhëtonin nga këto fshatra në qytetin e Gjakovës dhe anasjelltas dhe më në fund në kufirin midis Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Personat që udhëtonin në këmbë u dërguan drejtpërdrejt nga qyteti i Gjakovës në ndonjërin prej disa vendkalimeve kufitare. Njerëzit që udhëtonin me automjete së pari iu drejtuan qytetit të Prizrenit para se t'i afroreshin kufirit dhe kalonin në kufirin me Republikën e Shqipërisë.

(i) Prej datës 24 mars 1999 apo rreth kësaj dite, deri më 11 maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të detyronin banorët e Gjakovës të largoheshin. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shpërndaheshin nëpër qytet dhe shkonin shtëpi për shtëpi, duke urdhëruar shqiptarët e Kosovës të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Në disa raste, janë vrarë njerëz dhe shumë njerëz janë kërcënuar me vdekje. Shumë shtëpi dhe dyqane, që u takonin shqiptarëve të Kosovës, janë djegur, kurse ato që u takonin serbëve janë mbrojtur. Më 24 mars 1999, xhamia e vjetër në Rogovë dhe lagja historike e Gjakovës duke përfshirë çarshinë e vjetër, Xhaminë e Hadumit dhe Bibliotekën Islamike të bashkëngjitur ishin ndër disa objekte kulturore që u shkatërruan dukshëm ose plotësisht.

Gjatë periudhës prej 2 deri më 4 prill 1999, mijëra shqiptarë të Kosovës, banorë të Gjakovës dhe të fshatrave përreth, iu bashkuan një kolone të gjatë njerëzish në këmbë apo me vetura, kamionë dhe traktorë, dhe shkuan në kufirin me Shqipërinë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i drejtuan të ikurit në rrugë të caktuara që më parë. Në postblloqe policore gjatë rrugës, ljetërnjoftimet dhe targat e makinave iu konfiskuan shumicës së shqiptarëve të Kosovës. Në disa raste, kamionët e Ushtrisë Jugosllave janë përdorur për të çuar njerëz deri në kufirin me Shqipërinë.

(ii) Për më tepër, në fund të marsit dhe në prill të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i dëbuan me dhunë banorët shqiptarë kosovarë të shumë fshatrave të komunës së Gjakovës, duke përfshirë fshatrat Dobrosh, Korenicë dhe Mejë. Shumë prej këtyre banorëve më vonë u urdhëruan ose u lejuan të ktheheshin në vendbanimet e tyre, vetëm për t'u dëbuar përsëri nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Carragojsit, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve, duke përfshirë banorët e mbetur të fshatrave të lartpërmendura. U dislokuan një numër i madh ushtarësh dhe policësh dhe u ngritën disa postblloqe. Në Mejë, Korenicë dhe Orizë, një numër i madh dhe ende i pacaktuar burrash civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që po iknin, u rrëmbyën, dhe u vranë. Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkëngjiteshin disa kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina dhe me në fund kaluan në Shqipëri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i konfiskuan dokumentet personale të shumë shqiptarëve të Kosovës para se të kalonin kufirin.

i. Gjilan: Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë hyrë në fshatin Përlepticë më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date dhe u kanë dhënë urdhër banorëve që të largoheshin duke u thënë se fshati do të minohej të nesërmen. Banorët u larguan dhe u përpoqën të hynin në një fshat tjetër, por i ktheu policia. Më 13 prill 1999, banorët e Përlepticës përsëri u lajmëruan se fshati duhej të zbrazej deri të nesërmen. Në mëngjesin e të nesërmes, banorët shqiptarë të Kosovës u larguan në një kolonë prej afro 500 mjetesh transporti. Pak pas largimit të banorëve, shtëpive në Përlepticë iu vu zjarri. Në tërë komunën e Gjilanit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht i dogjën dhe shkatërruan shtëpi, dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve të Kosovës, duke përfshirë një xhami në Llashticë. Shqiptarët e Kosovës në fshatra të tjera në komunën e Gjilanit gjithashtu u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Mijëra njerëz të zhvendosur nga fshatrat si Zhegër, Nosalë dhe Lladovë kërkuan strehim në fshatin Stubëll të Poshtme në komunën e Vitisë. Shumë prej këtyre njerëzve të zhvendosur nga Gjilani kaluan kufirin e Kosovës me Serbinë, ku iu nënshtruan ngacmimeve dhe keqtrajttimeve të ngjashme me ato që i përjetuan në Kosovë, para se të hynin në Maqedoni. Të tjerët shkuan

drejt në Maqedoni. Kur shqiptarët kosovarë erdhën në kufirin me Maqedoninë, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ua konfiskuan dokumentet personale.

j. Ferizaj: Gjatë periudhës prej 24 marsit deri më 14 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i granatuan dhe sulmuan fshatrat në komunën e Ferizajit, duke përfshirë fshatrat Bibë, Prelez i Muhaxherëve, Rakaj dhe Katund i Vjetër, duke vrarë një numër banorësh. Pas granatimit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në disa fshatra duke përfshirë Papazin dhe Sojevën dhe urdhëruan banorët të largoheshin. Shqiptarë kosovarë të tjerë nga Varoshi dhe Mirosala ikën nga fshatrat e tyre kur hynë forcat serbe. Pasi banorët kishin lëshuar shtëpitë e tyre, ushtarët dhe policët i dogjën ato. Personat e zhvendosur shkuan në qytetin e Ferizajit, ku shumica hypën në trenat të cilët i çuan në vendkalimin kufitare me Maqedoninë në Han të Elezit. Forcat serbe i drejtuan udhëtarët e trenave të ecnin në binarët hekurudhorë deri në kufi. Të tjerët udhëtuan në kolona prej Ferizajit deri në këtë vendkalim kufitar. Në kufi, forcat serbe ua konfiskuan të gjitha dokumentet.

k. Kaçanik: Prej muajit mars deri në maj të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatrat në komunën e Kaçanikut dhe vetë qytetin Kaçanik. Ky sulm rezultoi në shkatërrimin e shtëpive dhe të objekteve fetare, duke përfshirë, ndër të tjera, xhamitë e Kotlinës dhe të Ivajës.

(i) Më 8 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e sulmuan dhe pjesërisht e dogjën fshatin Kotlinë. Më 24 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përsëri sulmuan Kotlinën me sisteme të armatimit të rëndë dhe ushtarë. Shumë burra, banorë të Kotlinës, ikën në pyje të afërta gjatë këtij sulmi, derisa forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan gratë, fëmijë dhe pleqtë që të hypnin në kamionë, të cilët i çuan në qytetin e Kaçanikut. Ata për të cilët s'kishte vend nëpër kamionë u detyruan të ecnin pas tyre drejt Kaçanikut. Një mumër burrash, banorë të Kotlinës, u vranë gjatë këtij sulmi, duke përfshirë së paku 12 burra, kufomat e të cilëve u hodhën në puse. Para se të largoheshin nga Kotlina, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e dogjën pjesën e mbetur të fshatit. Shumë nga ata që mbetën gjallë ikën në Maqedoni.

(ii) Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth kësaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan qytetin e Kaçanikut. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përdoqën, arrestuan, rrahën dhe pushkatuan shumë banorë shqiptarë kosovarë të Kaçanikut. Mijëra njerëz ikën në pyje të afërta dhe më në fund kaluan më këmbë kufirin me Maqedoninë. Personat e tjerë të zhvendosur nga qyteti i Kaçanikut dhe fshatrat përreth ecën këmbë në fshatin Stagovë, ku hypën në trena të cilat i çuan në kufirin me Maqedoninë.

(iii) Më 13 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësores dhe policore hynë në fshat dhe i plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, 13

civilë janë vrarë me armë zjarri. Pas këtij sulmi, një pjesë e madhe e popullatës së Sllatinës ikën në Maqedoni.

(iv) Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Lisnajë në komunën e Kaçanikut. Gjatë sulmit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë disa shqiptarë kosovarë, banorë të Lisnajës. Shumë banorë të Lisnajës formuan një kolonë traktorësh me rimorkio dhe ikën në Maqedoni. Banorët e tjerë ikën në fshatra të tjera ose në pyje para se e kaluan më në fund kufirin me Maqedoninë.

l. Deçan: Më 29 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan dhe sulmuan fshatin Beleg dhe fshatra të tjera përreth në komunën e Deçanit. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkuan shtëpi për shtëpi dhe u thanë fshatarëve që t'i lëshonin shtëpitë e tyre menjëherë. Rreth 300 burra, gra dhe fëmijë u nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u mblodhën në një fushë të afërt në fshatin Beleg. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan të gjithë burrat dhe gratë që të zhvisheshin dhe tërë prona e tyre personale u konfiskua. Burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët dhe u morën në bodrumin e një shtëpie të pambaruar afër fushës. Gjatë natës, së paku tri gra u sulmuan seksualisht. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u thanë fshatarëve që të largoheshin nga fshati në kamionë dhe traktorë dhe të shkonin në Shqipëri.

m. Vushtrria: Më 27 mars 1999 ose rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të digjin shtëpi në qytetin e Vushtrrisë dhe dogjën xhaminë kryesore në këtë qytet. Më 2 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan një numër fshatrash në drejtimin verilindor nga qyteti i Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Skromë, Sllakofc, Ceceli dhe Studime e Epërme. Fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë shtëpi, dyqane dhe objekte fetare u dogjën plotësisht. Fshatarët, bashkë me njerëz të zhvendosur më parë nga vendbanime të tjera në komunën e Vushtrrisë, u detyruan të formonin një kolonë prej rreth 20,000 njerëzish që udhëtonin në rrugën e Grykës së Studimes, në drejtim të qytetit të Vushtrrisë. Gjatë natës së datave 2-3 maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përndoqën, rrahën dhe vranë afërsisht 104 shqiptarë kosovarë dhe u vodhën artikuj me vlerë shumë të tjerëve. Mijëra shqiptarë kosovarë në këtë kolonë u ndaluan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore afër qytetit të Vushtrrisë. Më 3 maj 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore i ndanë burrat shqiptarë kosovarë të moshës ushtarake nga gratë, fëmijët dhe pleqtë. Gratë, fëmijët dhe pleqtë shqiptarë kosovarë u udhëzuan të shkonin në Shqipëri dhe një numër burrash shqiptarë kosovarë u detyruan të ngitnin automjete nga kooperativa bujqësore në një burg në fshatin Smrekonicë. Pas disa javësh ndalimi në kushte çnjerëzore, ku iu nënshtuan rrahjeve, torturës dhe vrasjeve, shumë nga këta burra shqiptarë të Kosovës u transportuan në fshatin Zhur, afër kufirit me Shqipërinë dhe u detyruan të kalonin në Shqipëri.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Millan MILLUTINOVIQI**, **Nikolla SHAINOVIQI**, **Dragolub OJDANIQI** dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur

planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

Pika 1: Deportimi, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (d) të Statutit të Tribunalit.

PIKA 2 **VEPRIME TË TJERA ÇNJERËZORE (TRANSFERIM I DHUNSHËM)**

64. Lidhur me ata shqiptarë kosovarë të cilët u zhvendosën brenda territorit të Kosovës, Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 55 – 61. duke iu referuar atyre, dhe në veçanti paragrafin 59.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI** dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

Pika 1: Veprime të Tjera Çnjerëzore (Transferim i Dhunshëm), **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (d) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 3-4 **VRASJE**

65. Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 55 –63. duke iu referuar atyre.

66. Duke filluar nga 1 janari i vitit 1999 apo rreth kësaj date dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **Slobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT** dhe **Vllajko STOJILKOVIQIT** dhe persona të tjera të njohur dhe të panjohur, kanë vrarë qindra civilë shqiptarë të Kosovës. Këto vrasje u bënë në mënyrë sistematike anembanë krahinës së Kosovës dhe shkaktuan vdekjen e shumë burrave, grave dhe fëmijëve. Ndër incidentet e vrasjeve në masë janë përfshirë këto:

a. Më 15 janar 1999 apo rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, fshati Reçak në komunën e Shtimjes u sulmua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Pas granatimit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat më vonë në orët e paraditës dhe filloi bastisjet shtëpi për shtëpi. Fshatarët të cilët kërkonin të iknin prej forcave të RFJ-së dhe të Serbisë u vranë kudo në fshat. Një grup prej afro 25 burrave u përpoqën të fshiheshin në një ndërtesë, por u zbuluan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Ata u rrahën dhe pastaj u çuan në një kodër të afërt, ku u vranë me armë zjarri. Gjithsej, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë rreth 45 shqiptarë të Kosovës në Reçak dhe rreth tij. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën A, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

b. Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan dhe sulmuan fshatin Bellacërkë në komunën e Rahovecit. Shumë banorë të Bellacërkës ikën gjatë lumit Belaja jashtë fshatit dhe u detyruan të kërkonin strehim afër një ure hekurudhore. Derisa forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i afroreshin urës, ata hapën zjarr kundër një numri fshatarësh, duke vrarë 12 veta,

10 prej tyre gra dhe fëmijë. Një fëmijë dyvjeçare mbeti gjallë pas këtij incidenti. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj urdhëruan fshatarët e tjerë të dilnin nga shtrati i përroit. Në këtë moment burrat dhe djemtë më të mëdhenj u ndanë nga pleqtë, gratë dhe fëmijët e vegjël. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj urdhëruan burrat dhe djemtë më të mëdhenj të zhvisheshin dhe ua plaçkitën sistematikisht të gjithë artikujt me vlerë. Grave dhe fëmijëve pastaj u dhanë urdhër për t'u larguar drejt një fshati të afërt, të quajtur Xërxë. Një mjek nga Bellacërka u përpoq të fliste me një komandant të forcave sulmuese, por ai u vra me armë zjarri, si edhe nipi i tij. Burrave dhe djemve më të mëdhenj të tjerë pastaj u është dhënë urdhri të ktheheshin në shtratin e përroit. Pasi zbatuan urdhrin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr kundër këtyre burrave dhe djemve më të mëdhenj, duke vrarë rreth 65 shqiptarë të Kosovës. Një numër burrash dhe djemsh më të mëdhenj mbetën gjallë pas këtij incidenti dhe persona të tjerë të cilët ishin fshehur në rrethinë gjithashtu e panë këtë incident. Për më tepër, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë gjithashtu vranë gjashtë burra të cilët i gjetën, të fshehur në një kanal vaditës të afërt. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën B, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

c. Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatrat Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël në komunën e Rahovecit. Fshatarët e Krushës së Vogël u strehuan në një pyll afër Krushës së Vogël, ku patën mundësi të shihnin forcat e RFJ-së dhe të Serbisë që sistematikisht plaçkitnin dhe digjnin shtëpitë e tyre. Fshatarët pastaj u strehuan në shtëpinë e Sejdi BATUSHËS, e cila gjendet në periferi të Krushës së Vogël. Gjatë paraditës së 26 marsit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i gjetën fshatarët. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan gratë dhe fëmijët të largoheshin dhe të shkonin në Shqipëri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj i ndaluan dhe kontrolluan burrat dhe djemtë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet dhe artikujt me vlerë. Pastaj forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i urdhëruan burrat dhe djemtë, nën kërcënimin e vdekjes, të ecnin drejt një shtëpie të zbrazët në Krushën e Vogël. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i detyruan burrat dhe djemtë të hynin në këtë shtëpi. Kur burrat dhe djemtë ishin mbledhur brenda, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr me mitraloz mbi ta. Pas të shtënave që zgjatën disa minuta, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i vunë zjarr shtëpisë për t'i djegur kufomat. Si pasojë të pushkatimeve dhe të zjarrit, vdiqën rreth 105 burra dhe djem shqiptarë të Kosovës. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën C, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

d. Më 26 mars 1999 ose rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e rrethuan afërsinë e oborrit të familjes BERISHA në Suharekë (komuna e Suharekës). U vunë në pozitë tanksat, të drejtuara kundër shtëpive. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan banorët të dilnin nga shtëpitë. U ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe u vranë gjashtë anëtarë të familjes. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përçuan anëtarët e tjerë në drejtim të një kafeneje. Këta anëtarë u futën në kafene, bashkë me tri grupe të familjes së gjerë të Berishëve. Pastaj forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në kafene dhe hapën zjarr kundër njerëzve aty brenda. U hodhën edhe eksplozive në kafene. Së paku 35 civilë u vranë në këtë aksion dhe u plagosën rëndë edhe të tjerë. Kufomat e viktimave u tërhoqën zvarrë prej kafenesë dhe u vendosën në platformën e një kamioni, i cili pastaj u nis në drejtim të Prizrenit. Tre individë të plagosur, të cilët u hodhën në kamion bashkë me kufomat, kërcyen prej kamionit gjatë rrugës për në Prizren. Plaça që u takonin së paku gjashtë prej personave të vrarë në kafene janë gjetur në një vendvarrim masiv të fshehur në një poligon të UJ-së afër

Korishës. Për më tepër, dokumentet personale që u takonin së paku pesë prej personave që u vranë në kafene janë gjetur në kufomat që u zhvarrosën prej një varri masiv të fshehur në Batajnicë afër Beogradit në Serbi. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën K, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

e. Në mbrëmjen e 26 marsit të vitit 1999 apo rreth kësaj date, në qytetin e Gjakovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë erdhën në një shtëpi në Rrugën Ymer Grezda Nr. 134a. Gratë dhe fëmijët brenda shtëpisë u ndanë nga burrat dhe u urdhëruan të ngjiteshin në katin e sipërm. Atëherë forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë me armë zjarri të gjashtë meshkujt shqiptarë të Kosovës që ishin në këtë shtëpi. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Shtesën D, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

f. Më 26 mars 1999 apo rreth kësaj date, në orët e mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Padalishtë të komunës së Istogut. Derisa po hynin në fshat, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëlluan mbi shtëpitë dhe mbi fshatarët që përpiqeshin të iknin. Tetë anëtarë të familjes së Bekë IMERAJ-it u dëbuan me forcë nga shtëpia dhe u vranë para shtëpisë së vet. Banorë të tjerë të Padalishtës janë vrarë në shtëpitë e tyre dhe në një shtrat përroi afër fshatit. Gjithsej, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë afro 20 shqiptarë të Kosovës nga Padalishta. (Të vrarët që dihen me emër janë radhitur në Shtesën E, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

g. Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë granatuan fshatin Izbicë në komunën e Skënderajt me sisteme të armatimit të rëndë. Së paku 4,500 fshatarë nga Izbica dhe fshatrat përreth u strehuan në një lëndinë në Izbicë. Më 28 marsit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatarët dhe iu afruan atyre, duke u kërkuar para. Pasi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u vodhën fshatarëve artikujt me vlerë, i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Meshkujt pastaj u ndanë në dy grupe. Njëri grup u dërgua në një kodër të afërt kurse tjetri u dërgua në shtratin e një përroi të afërt. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj qëlluan mbi të dyja grupet e burrave dhe rreth 116 shqiptarë të Kosovës u vranë. Gjithashtu më 28 mars 1999, gratë dhe fëmijët që ishin mbledhur në Izbicë u detyruan të largoheshin dhe të ecnin këmbë drejt Shqipërisë. Dy plaka të të paaftha ishin ulur në rimorkion e një traktori dhe nuk mund të ecnin. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ia vunë zjarrin rimorkios dhe të dyja plakat u dogjën të gjalla. (Të vrarët në Izbicë që dihen me emër janë radhitur në Shtesën F që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

h. Përafërsisht në orët e vona të mbrëmjes të datës 1 prill 1999 dhe duke vazhduar në orët e hershme të mëngjesit të 2 prillit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një aksion kundër lagjes Qerimi të Gjakovës. Gjatë një periudhe prej disa orësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë me forcë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në lagjen Qerimi, vranë banorët dhe u vunë zjarr shtëpive. Dhjetëra shtëpi u shkatërruan dhe mbi 50 persona u vranë. Për shembull, në një shtëpi në Rrugën Millosh Gilliq Nr. 157, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pushkatuan njerëzit që ishin brenda dhe pastaj i vunë zjarr shtëpisë. Si pasojë e pushkatimeve dhe të zjarreve të ndezura nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vetëm në këtë vend, 20 shqiptarë të Kosovës janë vrarë, duke përfshirë 19 gra dhe fëmijë. (Emrat e të vrarëve në këtë vend janë radhitur në Shtesën G, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

i. . Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Carragojsit, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve, duke përfshirë banorët e mbetur të fshatrave të lartpërmendura. U dislokuan një numër i madh ushtarësh dhe policësh dhe u ngritën disa postblloqe. Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkoheshin disa kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina. Në Mejë, Korenicë dhe Orizë, një numër i madh dhe ende i pacaktuar burrash civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që po iknin dhe u rrëmbyën. Shumë prej këtyre burrave u ekzekutuan menjëherë, dhe rreth 300 persona ende mungojnë. Dokumentet personale që u takonin se paku shtatë personave të cilët u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999 u gjetën në kufomat që u zhvarrosën nga një varr masiv i fshehur në Batajnicë, afër Beogradit në Serbi. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Shtesën I, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

j. Më 2 maj 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan disa fshatra në drejtimin verilindor nga qyteti i Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Skromë, Sllakoc, Ceceli dhe Studime e Epërme. Fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë prej shtëpive, dyqaneve dhe objekteve fetare të tyre u dogjën plotësisht. Me vonë u radhitën me forcë në një kolonë prej rreth 20,000 njerëzve, e cila u nis në rrugën e grykës së Studimes, drejt qytetit të Vushtrrisë. Gjatë këtyre veprimeve, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ngacmuan, rrahën, dhe plaçkitën shqiptarë kosovarë që udhëtonin në kolonë dhe vranë rreth 104 shqiptarë të Kosovës. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën H, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

k. Më 22 maj 1999 ose rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, një rojë burgu në uniformë në kompleksin e Burgut të Dubravës (komuna e Istogut) lajmëroi prej kullës së vrojtimit se të gjithë të burgosurit duhej të mblidhnin plaçkat e tyre personale dhe të radhiteshin në fushën e sportit në kompleksin e burgut për transferim në burgun e Nishit në Serbi. Brenda një kohe shumë të shkurtër, qindra të burgosur u mblodhën në fushën e sportit me plaçkat e tyre në çanta dhe u radhitën për të pritur transportim. Pa paralajmërim, personat e uniformuar hapën zjarr kundër të burgosurve prej kullës së vrojtimit, prej vrimave ne murin rrethues dhe prej foleve të zjarrit jashtë murit. Shumë të burgosur u vranë menjëherë dhe të tjerë u plagosën.

(i) Më 23 maj ose rreth kësaj date, pasdite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hodhën granata dhe qëlluan në kanalet e shkarkimit, kanalet e ujërave të zeza, në godina dhe bodrume, duke vrarë dhe plagosur shumë të burgosur të tjerë të cilët kishin kërkuar strehim në këto vende pas ngjarjeve të ditës së mëparshme. Rreth 50 të burgosur gjithsej u vranë. (Shumë prej të burgosurve të vrarë mbeten të pafidentifikuar. Mirëpo, emrat e personave që dihen të jenë vrarë janë radhitur në Shtesën J, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

l. Midis muajve mars dhe maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërmorën një sërë ofensivash masive kundër disa fshatrave në komunën e Kaçanikut, të cilat shkaktuan vdekjen e më shumë se njëqind civilëve.

(i) Më 24 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Kotlinë. Gjatë sulmit, shumica e shtëpive u dogjën dhe se paku 17 persona u vranë. Disa prej këtyre të vrarëve u kapën në pyll, u ekzekutuan dhe u hodhën në puse. Janë hedhur eksplozivë në puse.

(ii) Më 13 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësoresë dhe ato policore hynë në fshat dhe plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, 13 civilë janë vrarë me armë zjarri.

(iii) Më 21 maj 1999 ose rreth kësaj date, fshati Stagovë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Popullata u përpoq të ikte drejt maleve në lindje të fshatit. Gjatë këtij aksioni, së paku 12 persona u vranë. Pjesa më e madhe e fshatit u plaçkit dhe u dogj.

(iv) Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Lisnajë. Derisa forcat hynin në fshat, popullatës i është dhënë urdhri që të mblidhej në shkollë dhe të largohej nga fshati me traktorë. Pastaj u ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Gjatë këtij aksioni, janë vrarë katër burra. Për më tepër, katër anëtarë të familjes Qorri u vranë në përpjekje për të ikur drejt pyjeve. (Personat e vrarë në komunën e Kaçanikut, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën L, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

Me këto veprime dhe mosveprime, **Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI** dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

Pika 3: Vrasje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (a) të Statutit të Tribunalit.

Pika 4: Vrasje, një **SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit të Tribunalit dhe e njohur në Nenin 3 (1) (a) (vrasje) të Konventave të Gjenevës.

PIKA 5 PËRNDJEKJE

67. Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 55 –66. duke iu referuar atyre.

68. Duke filluar më 1 janar të vitit 1999 apo rreth kësaj dite dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT dhe VLLAJKO STOJILKOVIQIT**, shfrytëzuan mjetet dhe metodat e përshkruara në paragrafet 55 deri në 66 për të kryer një fushatë përndjekjeje kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës për arsye politike, racore, ose fetare. Në këto përndjekje përfshiheshin ndër të tjera këto metoda:

a) Transferimi dhe dëbimi i dhunshëm nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rreth 800,000 civilëve shqiptarë kosovarë, përshkruar në paragrafet 55-64.

b) Vrasja e qindra civilëve shqiptarë kosovarë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, përshkruar në paragrafet 65-66.

c) Sulmi seksual nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndaj shqiptarëve kosovarë, veçanërisht grave, duke përfshirë sulmet seksuale të përshkruara në paragrafet 57 dhe 63.

d) Shkatërrimi apo dëmtimi kuturu i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë. Gjatë dhe pas sulmeve mbi qytetet dhe fshatrat, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht dëmtuan dhe shkatërruan monumente kulturore dhe vende të shenjta myslimane. Xhamitë janë granatuar, djegur dhe hedhur në erë me dinamit anembanë krahinës. Të përfshira ndër këto incidente janë këto raste: dëmtimi dhe/ose shkatërrimi i xhamive në Vushtrri, Suharekë, Celinë, Rogovë, Bellacërkë, Qirez, Kotlinë, Ivajë, Brestofc. Krushë të Madhe, Mitrovicë, Llashticë, Landovicë, Gjakovë, përshkruar në paragrafin 63.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI** dhe persona të tjerë të njohur dhe të panjohur planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

Pika 5: Përndjekjet për arsye politike, racore, ose fetare, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (h) të Statutit të Tribunalit.

AKUZA TË PËRGJITHSHME

69. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ka ekzistuar një gjendje e konfliktit të armatosur në Kosovë, në RFJ.

70. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet që kualifikohen si krime kundër njerëzimit ishin pjesë të një sulmi të gjerë dhe sistematik kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës në RFJ.

FAKTE TË MËTEJSHME

71. Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë gjendet në pjesën jugore të Republikës së Serbisë, një republikë përbërëse e RFJ-së. Territori i tashëm i RFJ-së ishte pjesë e RSFJ-së. Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë kufizohet në veri dhe veriperëndim me Malin e Zi, një republikë tjetër përbërëse e RFJ-së. Në jugperëndim, Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë kufizohet me Republikën e Shqipërisë, kurse në jug me Maqedoninë. Kryeqyteti i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë është Prishtina.

72. Në vitin 1990, Republika Socialiste e Serbisë shpalli një Kushtetutë të re, me të cilën, ndër të tjera, iu ndryshuan emrat republikës dhe krahinave autonome. Emri i Republikës Socialiste të Serbisë u ndryshua në Republika e Serbisë; emri i Krahinës Autonome Socialiste e Kosovës u ndryshua në Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë (të dyja më tej “Kosova”); dhe emri i Krahinës Socialiste Autonome të Vojvodinës u ndryshua në Krahinë Autonome e Vojvodinës (më tej “Vojvodina”).

Gjatë kësaj periudhe, Republika Socialiste e Malit të Zi ndryshoi emrin në Republika e Malit të Zi.

73. Në vitin 1974, Kushtetuta e re e RSFJ-së parashihte decentralizimin e pushtetit qendror në të gjashtë republikat përbërëse të vendit. Brenda Serbisë, Kosova dhe Vojvodina fituan autonomi të gjerë, duke përfshirë kontrollin e sistemeve të tyre arsimore, të gjykatave dhe të policisë. Fituan gjithashtu kuvendet e tyre dhe përfaqësoheshin në Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese dhe Kryesinë e RSFJ-së.

74. Në regjistrimin e popullsisë së vitit 1981, regjistrimi i fundit me pjesëmarrje pothuajse të plotë, Kosova kishte përafërsisht 1,585,000 banorë, prej të cilëve 1,227,000 (77 për qind) ishin shqiptarë, ndërsa 210,000 (13 për qind) ishin serbë. Ka në dispozicion vetëm vlerësime për popullsinë e Kosovës në vitin 1991, sepse shqiptarët e Kosovës bojkotuan regjistrimin e popullsisë të organizuar në atë vit. Sipas vlerësimeve të përgjithshme, gjatë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, Kosova kishte midis 1.800.000 e 2.100.000 banorë, prej të cilëve rreth 85-90 për qind ishin shqiptarë të Kosovës dhe 5-10 për qind ishin serbë.

